



## Ftesë për ofertë

**Titulli: “Polisë e Sigurimit BBB – Bankers Blanket Bond Insurance Policy”**

**Data e hapjes për ofertim: 01/06/2026**

**Data e mbylljes për ofertim: 16/06/2026**

Institucioni Mikrofinanciar Agjencioni për Financim në Kosovë –AFK, fton kompanitë e Sigurimit të interesuara të paraqesin ofertat për “Polisë e Sigurimit BBB – Bankers Blanket Bond Insurance Policy”, me këto karakteristika si në vijim:

### 1. Informata të përgjithshme:

- Sigurimi BBB
- Sigurimi ECCP – Krimet Kompjuterike dhe Elektronike
- Periudha e sigurimit 12 muaj, me mundësi vazhdimi.

### 2. Kërkesat për ofertat financiare:

- Ju lutemi që ofertën tuaj ta dorëzoni tek zyrja e AFK-së në pajtim me specifikat e parashtruara në pikën 1 të këtij dokumenti.
- Të gjitha ofertat të dorëzohen në Euro, përfshirë TVSH-në, në të kundërtën në rast se çmimet dorëzohen pa e specifikuar TVSH-në, AFK do të konsiderojë se çmimet përfshijnë TVSH-në.

### 3. Kushtet e përgjithshme:

Oferta duhet të përmbaj informatat në vijim:

- Adresa e plotë dhe detajet kontraktuese të ofertuesit;
- Të përmbajë numrin e ofertës dhe datën e ofertës;
- Ofertën e specifikuar me çmime;
- Çdo faqe e ofertës duhet të vuloset dhe të nënshkruhet nga personi i autorizuar;
- Ofertës duhet t’i bashkangjitet Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe Çertifikata e numrit Unik (kopje).

#### **4.Kushtet dhe rregullat e tenderit:**

- Dokumentet duhet të vendosen në një zarf të mbyllur dhe të dorëzohen në zyrë të AFK-së; AFK do të pranojë vetëm ofertat e juaja të mbyllura në zarf, dhe nuk do të konsideroj asnjë formë tjetër të aplikimit.  
AFK nuk mban përgjegjësi për dëmtimin, humbjen apo mos pranimin e ofertave.
- Vlefshmëria e ofertës së paku një muaj.

Ofertat duhet të dërgohen të mbyllura në zarf me mbishkrimin “**Polisë e Sigurimit BBB – Bankers Blanket Bond Insurance Policy**” në adresën e zyrës qendrore të AFK-së në Pejë : Rruga “Lidhja e Prizrenit Nr.20” 30 000, ose edhe në mënyrë elektronike në adresën [prokurimi@afkonline.org](mailto:prokurimi@afkonline.org) .

**Afati i fundit i pranimit të ofertave: 16/06/2026**

*AFK mbanë të drejtën e anulimit ose të ndryshimit të shpalljes në çdo kohë.*